

Klinë: Arrestohet një person për armëmbajtje pa leje

LAJME

LAJMI I FUNDIT



Më afër lexuesit.

04/09/2023 16:22



Policia e Kosovës me një komunikatë për media ka njoftuar se në qytetin e Pejës është arrestuar një person.

Ai dyshohet për armë mbajtje pa leje, dhe në vendin e ngjarjes policia ka gjerë një revole, 2 karikatorë dhe dhjetra fishek.

Me vendim të prokurorit ai është liruar në procedurë të rregullt.

Njoftimi i plotë:

Arrestohet një person i dyshuar për armëmbajtje pa leje

Me datë 04.09.2023, rreth orës 10:15, Policia është njoftuar se në rrugën “ Ukë Zeneli” në Klinë, një person posedon armë.

Njësitet relevante të Stacionit Policor në Klinë, menjëherë kanë shkuar në shtëpinë e personit të dyshuar dhe i njëjti ka pranuar se posedon një armë të zjarrit pa leje.

Në vendin e ngjarjes janë gjetur dhe sekuestruar:

- Një (1) Armë (Pistoletë) prodhim Çekoslovak
- Dy (2) karikator të së njëjtës arme
- Pesëdhjetë e dy (52) fishek të kal: 7.65 mm

Për rastin është njoftuar Prokurori i shtetit, pas intervistimit me hetuesit me vendim të Prokurorit i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt, rasti cilësohet “Mbajtje në posedim, kontroll të paautorizuar të armeve”./Lajmi.net



Artikuj të ngjashëm



September 5, 2023

Vrasja që tronditi Prishtinën në gusht, një muaj paraburgim ndaj të...



September 5, 2023

1 muaj paraburgim për ish-kandidatin e AAK-së për asamble, “kokainën e...



September 5, 2023

Intervistohet nga Policia, ish kryetari i AAK-në në Prizren që “bastisi” ...



September 5, 2023

Ish-kryetari i AAK-së në Prizren kërcënon stafin e RTV Besa, reagon AGK-ja



September 5, 2023

A ka lift special për Albin Kurtin në restorantin e “Ridit”?...



September 5, 2023

Osmani nga qyteti i një mbi një dritareve bën thirrje për...